



KODI I ETIKES GJYQËSORE

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e “Kodi i Etikës Gjyqësore” me anë të Vendimit Nr.171, datë 22.04.2021, i cili përcakton parimet, normat dhe rregullat, të cilat udhëheqin sjelljen e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe veprimtarisë së tij jashtëgjyqësore.

Ky Kod synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe ligjin.

Kodi i Etikës Gjyqësore zbatohet nga të gjithë gjyqtarët e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Pjesë të këtij Kodi, të cilat kanë të bëjnë me jetën private, kanë natyrë këshillimore dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe nga gjyqtarët e komanduar në pozicione të tjera.

Rregullat e këtij kodi zbatohen për aq sa është e mundur edhe për nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykata, për këshilltarët ligjorë si dhe ndihmësit ligjorë. Të gjithë subjektet ndaj të cilëve zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë kod, duhet të marrin masa që të rregullojnë menjëherë marrëdhëniet dhe veprimtarinë e tyre në pajtim me rregullat e këtij Kodi.



Për të shkarkuar kodin e etikës ju lutem klikoni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose skanoni kodin 2 dimensional.



7 MAJ 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Gjyqtarët për Mediat dhe Nëpunësit Civilë Gjyqësorë për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median në gjykata, në datat 21 Prill dhe 6 Maj zhvilluan dy takime në distancë me studentët e vitit të tretë të Departamentit të Gazetarisë të Universitetit të Tiranës, që ndjekin kursin e Raportimit mbi Krimin dhe Gjykatat, i cili mbështetet nga Ambasada Britanike në Tiranë nëpërmjet zbatimit të projektit nga East-West Management Institute (EWMI).

Në këto dy sesione ndërvepruese, studentët patën mundësi të njihen me rolin e ri të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe eksperiencën profesionale të Gjyqtarëve për Mediat dhe të Nëpunësve Civilë Gjyqësorë për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median në gjykata. Ata u informuan mbi praktikën e marrjes së informacionit, procedurat dhe hapat për ndërveprimin me publikun dhe median, si dhe forcimin e marrëdhënieve me personat e kontaktit për median. Gjatë takimeve u theksua rëndësia për t'i bërë gjykatat më të hapura për gazetarët, me qëllim rritjen e transparencës përmes një raportimi të paanshëm dhe etik mbi veprimtarinë e sistemit gjyqësor.



Këshilli i Lartë Gjyqësor konfirmon angazhimin për të vazhduar këtë praktikë të suksesshme bashkëpunimi edhe në të ardhmen, në mënyrë që brezat e rinj të studentëve të njohin më mirë punën e gjykatave, gjatë procesit të tyre të formimit si gazetarë të ardhshëm, për t'i shërbyer sa më mirë informimit të publikut.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i përkushtuar për sigurimin e të drejtës për qasje në informacion dhe përmirësimin e komunikimit etik midis gjyqësorit dhe medias.

10 MAJ 2021



Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me rastin e 108 vjetorit të Ditës Kombëtare të Drejtësisë, organizuan një ceremoni zyrtare në mjediset e Polit të Drejtësisë. Ky aktivitet u hap me fjalën e mirëseardhjes së dy kryetarëve të Këshillave, Znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Z. Gent Ibrahim, Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët theksuan simbolikën domethënëse të kësaj dite të shënuar për sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, kjo ceremoni u përshëndet nga SH.S.Znj.Yuri Kim, Ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Sh.T.Z. Alexis Hupin, Drejtues i Seksionit Politik në Delegacionin e Bashkimit Evropian, Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Z. Olsian Çela, Prokuror i Përgjithshëm, Z. Arben Rakipi, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës si dhe Z. Medi Bici, Anëtar i KLGJ-së. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin gjyqtarë, prokurorë, përfaqësues të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, të organeve të rivlerësimit kalimtar dhe të medias.



Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Znj. Naureda Llagami, së bashku me Z. Dritan Hallunaj, anëtar i Këshillit, pritën në një vizitë një grup studentësh të fakultetit të drejtësisë të Universitetit “Luarasi”, të shoqëruar nga pedagogu, Z. Saimir Vishaj.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Znj. Llagami, pasi u uroi studentëve suksese në rrugëtimin e ardhshëm profesional, u shpreh se diplomimi i brezave të rinj është një provë bindëse për të gjithë, që reforma në drejtësi ka rritur besimin e të rinjve se në sistemin e drejtësisë futen, punojnë dhe promovohen vetëm individë me integritet dhe cilësi të larta profesionale. Gjatë bashkëbisedimit, studentët u njohën me rëndësinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor si organi kushtetues përgjegjës për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, duke siguruar pavarësi, paanësi, integritet dhe profesionalizëm në këtë sistem.

Në fund të fjalës përmbyllëse, Znj. Llagami shprehu bindjen se tashmë institucionet e drejtësisë janë garantuesit e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve shqiptarë, si dhe kontribues të sigurtë në zhvillimin dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

10 QERSHOR 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur një qëndrim publik, si organ i ngarkuar nga Kushtetuta për të garantuar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, se gjyqtarët në ushtrimin e funksioneve i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve dhe se ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit.

Dhënia e drejtësisë duhet të jetë e çliruar nga çdo lloj ndikimi, ndërhyrjeje të subjekteve publike ose private. Ky është kusht i domosdoshëm për garantimin e shtetit të së drejtës. Ndërhyrje të tilla nuk bëjnë gjë tjetër, veçse nxisin në publik ndjenjën e armiqësisë ndaj pushtetit gjyqësor, krijojnë imazhin e gabuar mbi gjyqësorin dhe bien ndesh me qëllimet dhe objektivat e reformës në drejtësi, si dhe cenojnë rëndë figurën dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Gjithashtu, ato ndikojnë negativisht në ushtrimin e detyrës nga gjyqtarët, për t'i detyruar ata të japin vendime në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë, të papranueshme në shtetin e së drejtës, në të cilin mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë, sipas legjislacionit në fuqi, jo përbaltja e gjykatës, apo e gjyqtarit.



Gjatë datave 10-12 Qershor 2021, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, zhvilloi disa takime në gjykatat e rretheve gjyqësore, si dhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ, përkatësisht: Durrës, Kavajë, Berat, Lushnje, Krujë, Lezhë, Mat dhe Kurbin.

Znj. Naureda Llagami, diskutoi jo vetëm mbi problematikat e sistemit gjyqësor, por dhe mbi nevojat e gjyqtarëve dhe gjykatave në këto rrethe me qëllim rritjen e efijencës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore, duke vendosur theksin dhe te projekt-propozimi për një Hartë të re Gjyqësore.

Këto aktivitete u zhvilluan në kuadër të zbatimit të projektit “Mbështetje për Mjetet Juridike Kombëtare për Lehtësimin e Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së” të Këshillit të Evropës, të financuar nga Bashkimi Evropian.



Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami, priti në një takim pune ambasadorin e Bashkimit Evropian në Tiranë, SH.T.Z. Luigi Soreca, i cili ishte i shoqëruar nga Znj. Lenka Vitkova, Drejtuese e Shtetit të së Drejtës dhe Mirëqeverisjes në Delegacionin e BE në Shqipëri.

Të pranishmit diskutuan rezultatet dhe sfidat e KLGJ-së dhe të sistemit gjyqësor në tërësi, jo vetëm në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi, por edhe përgjatë kohëve sfiduese të pandemisë globale Covid-19.

Bashkëbiseduesit e përqendruan diskutimin e tyre si në përpjekjet e KLGJ-së për plotësimin e mëtejshëm të Gjykatës së Lartë me gjyqtarë, si dhe në marrjen e masave për rritjen e efijencës përmes diskutimit dhe miratimit të projekt-propozimit për hartën e re gjyqësore, me qëllim sigurimin e funksionalitetit të veprimtarisë së gjykatave të apelit dhe atyre të shkallës së parë.


Në mbyllje të këtij takimi Ambasadori Soreca e njohu Znj. Llagami dhe me mekanizmat e reja të asistencës teknike që Delegacioni i BE do të zbatojë në të ardhmen e aftërt, duke synuar ofrimin e një mbështetje të dedikuar për institucionet e pavarura të drejtësisë.



Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit i Fakultetit të Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës nënshkruan një Marrëveshje Mirëkuptimi, e cila do t'u mundësojë studentëve të vitit të tretë në kursin "Raportimi mbi Gjykatat dhe Krimin" zhvillimin e praktikave në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe vizita në Gjykata.

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi u realizua në kuadër të bashkëpunimit me Projektin "Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimi i efikasitetit të Gjykatës së Lartë" i mundësuar nga Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) dhe me Projektin "Forcimi i Standardeve të Integritetit të Medias", i financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë, projekte të zbatuar nga East-West Management Institute (EWMI).

Veprimtaria e KLGJ-së (Prill - Qershor 2021):



- 22 mbledhje plenare
- 156 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 39 akte kolektive, Prill 2021
 - 9 akte kolektive, Maj 2021
 - 12 akte kolektive, Qershor 2021
 - 25 akte individuale, Prill 2021
 - 20 akte individuale, Maj 2021
 - 37 akte individuale, Qershor 2021

Pjesa tjetër përfshihen rregulla të brendshme, aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare dhe hartimin e aktit nënligjor me karakter normative si dhe udhëzime.

MASAT E MARRA PËR FUNKSIONALITETIN E SISTEMIT GJYQËSOR

- Për shkak të nevojës për t'i dhënë përparësi plotësimin të vakancave në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Këshilli gjatë 3 mujorit të dytë 2021, vendosi miratimin e **20 raporteve të vlerësimit etik dhe profesional**, për 10 gjyqtarë, si parakusht i ekzistencës së dy vlerësime të mëparshme etiko profesionale për gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Këshilli ka vendosur hapjen/rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për **8 pozicione të lira** dhe në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për **4 pozicione të lira**.
- Këshilli ka vendosur ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Miliana Muça, në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të z. Erjon Çela dhe caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në këtë Gjykatë, të gjyqtarës znj. Flora Hajredinaj. Ndërkohë ka përfunduar verifikimi i kushteve dhe kriterëve ligjore për 2 kandidatë, për procedurën e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave, për pozicionet e lira.
- Mbi propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli hapi/rihapi **6 procedura ngritjeje në detyrë** në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.
- Në fokus të veprimtarisë së tij gjatë këtyre muajve Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata edhe përmes skemës së delegimit, në të cilën u përfshinë **3 gjyqtarë** dhe të transferimit të përkohshëm me pëlqim të **5 gjyqtarëve**.
- Në përputhje me dispozitat ligjore, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, të pasurisë dhe të figurës, për **35 kandidatë** për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022, proces i cili do shërbejë në të ardhmen për plotësimin e vakancave pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atë administrativ.
- Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor trajtoi **250 kërkesa për caktimin e 301 gjyqtarëve** të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

DISIPLINA



Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar paraprakisht **3 kërkesa ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë**, për fillimin e procedimit disiplinor, me objekt shkarkim nga detyra si dhe një ndër to përfshinte kërkesën për pezullimin e menjëhershëm nga ushtrimi i detyrës.

Këshilli ka konkluduar për secilën kërkesë si më poshtë:

- Dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të një magjistrati dhe mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore ndaj dy ish-magjistratëve.
- Pezullimin nga detyra të një magjistrati, deri në përfundimin e procedimit disiplinor iniciuar nga ILD.
- Shtyrjen e seancës dëgjimore për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të një magjistrati, në funksion të garantimit të mbrojtjes efektive dhe procesit të drejtë ligjor.

HARTA E RE GJYQËSORE

Me synimin për të krijuar një sistem gjyqësor sa më efikas, duke prioritetizuar aksesin në drejtësi për qytetarët; uljen e kostove; rritjen e cilësisë dhe performancës së duhur në dhënien e drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka vlerësuar hartën gjyqësore si një nga prioritetet e tij kryesore.

Faza aktuale në të cilën ndodhet procesi:

- Ka përfunduar hartimi i raportit për Hartën Gjyqësore, dhe i është vënë në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë, si palë bashkëpropozuese e Hartës Gjyqësore.
- Në vazhdimësi, ky raport do të duhet të jetë objekt i një procesi konsultimesh edhe me palët e tjera të përfshira në këtë proces, sic janë; Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
- Grupi teknik i punës, i ngritur me përfaqësues të KLGJ-së, të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në bashkëpunim me ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë; Euralius, USAID dhe Këshilli i Evropës, po vazhdon punën edhe me takime online, **për hartimin e studimit të fsibilitetit**, në lidhje me impaktin që do të ketë në të ardhmen, zbatimin e hartës së re gjyqësore. Ky studim është aktualisht në diskutim dhe do të konsultohet midis palëve, pasi tashmë është dorëzuar një “raport studimi” nga grupi i punës që e ka përgatitur dhe që më pas, do të jetë pjesë përbërëse e draft raportit të Hartës Gjyqësore.

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Mbështetur në problematikat e evidentuara, Këshilli ka projektuar ndërhyrje strategjike në sistemin aktual të menaxhimit të çështjeve, të cilat për herë të parë në 15 vjet, janë përcaktuar nga vetë përdoruesit e tij.

Falë këtij procesi janë realizuar 84 ndryshime strategjike duke maksimizuar impaktin, në funksion të rritjes së transparencës, efijencës dhe aksesit të qytetarëve në vendimmarrjet e gjykatave. Ndërhyrjet kryesore janë të fokusuara në:

- përshtatjen e sistemit me programet e reja,
- anonimizimin automatik të vendimeve gjyqësore,
- ndërveprimin me regjistrin e Gjendjes Civile dhe QKB,
- gjurmimin e veprimeve administrative të dosjes duke shmangur abuzimet,
- paralajmërimin për afatet e shqyrtimit të çështjeve,
- rritjen e cilësisë dhe saktësisë së raporteve,
- përditësimin me kuadrin ligjor në fuqi.


Drejtoria e IT dhe Menaxhimit të çështjeve gjatë periudhës Prill – Qershor 2021 ka asistuar nëpunësit IT në Gjykata mbi proceset e punës si dhe ka zhvilluar trajnime individuale.

TRANSPARENCA

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar **15 kërkesa për informacion**, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar **142 shkresa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

KLJGJ ka vijuar bashkëpunimin e frytshëm dhe intensiv me partnerët ndërkombëtarë, BE, SHBA, Këshillin e Europës, përfaqësitë diplomatike të akredituara në RSH, organizata të shoqërisë civile, si dhe institucionet më të rëndësishme të vendit si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magistraturës, etj.





KLGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

974

-na ndiqni-

Adresa: Godina “Poli i Drëjtësisë”, Rruga”Ana Komnena”,
Tiranë

www.klgj.al

email: kontakt@klgj.al